

VENDIM
Nr. 338, datë 6.6.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 103, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT DHE PYJEVE",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, pika 1, dhe 11, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 16, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Në titull dhe në vendim, emërtimi "Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave" dhe akronimi "ISHMPU" zëvendësohen përkatësisht me "Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit" dhe "ISHMPUT".

b) Kudo në vendim, fjalët "... ministria që mbulon fushën e mjedisit ..." dhe "... ministri përgjegjës për mjedisin ..." zëvendësohen me "... ministria që mbulon fushën e turizmit dhe mjedisit ..." dhe "... ministri përgjegjës për turizmin dhe mjedisin ...".

c) Kudo në vendim, fjalët "... në fushën e mjedisit, pyjeve dhe ujërave ..." zëvendësohen me "... në fushën e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit ...".

ç) Pikat 1, 2, 3, të kreut të II, ndryshohen si më poshtë vijon:

"1. ISHMPUT-ja ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes nga kundërvajtjet administrative të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit.

2. ISHMPUT-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit që lidhen me dënimet për kundërvajtjet administrative në fushën përkatëse, në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2, të këtij kreu, ISHMPUT-ja është përgjegjëse për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, për inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e turizmit dhe mjedisit, lidhur me kundërvajtjet administrative."

d) Shkronjat "dh" dhe "e", të pikës 3, të kreut III, ndryshohen si më poshtë vijon:

"dh) siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit lidhur me dënimin për kundërvajtjet administrative;

e) ushtron çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe turizmin nga kundërvajtjet administrative."

dh) Në pikën 7, të kreut III, pas fjalëve "... drejtorin përgjegjës për inspektimin e ujërave;" shtohen "... drejtorin përgjegjës për inspektimin në fushën e turizmit;"

2. Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), të cilët kryejnë funksionet e inspektimit për kundërvajtjet administrative në fushën e turizmit, funksione të cilat kalojnë në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, transferohen me përparësi pranë ISHMPUT-së, në zbatim të legjislacionit të nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucioneve.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shkronja "e", e pikës 4, të kreut II, të vendimit nr. 36, datë

20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, shfuqizohet.

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi